# Skandal/ Disiplina fal dhunen ne Lac

nga AlbaniaSoccer
E martë, 24 Shtator 2013 22:12



Komisioni Disiplines ka falur dhunen ne Lac. Ne ndeshjen qe luajti Laci me Bylisin pak dite me pare, presidentet e dy klubeve u perplasen me njeri tjetrin dhe lojtaret ballshit u dhunuan nga drejtuesit e Lacit. Delegati dhe vezhguesi i FSHF i ka pare te gjitha skenat por asgje nuk ka ndodhur. Komisioni Disiplines e ka falur Lacin pa marre asnje vendim per kete qe ka ndodhur ndersa pak dite me pare ka denuar me mbylljen e stadiumit dhe heqjen e tri pikeve Flamurtarit per nje ngjarje te afert. Disiplina pezullohet pese jave sulmuesi i Tiranes Komisioni i Disiplines ka denuar me pese jave pezullim sulmuesin e Tiranes. Vedran Gerc nuk do te luaj per skuadren bardheblu ne ndeshjet e ardhshme pasi nje xhest antisport bere prej tij ne Shkoder nuk eshte toleruar nga FSHF. Sulmuesi i Tiranes goditi lojtarin e Vllaznise Rajovic me grusht dhe sipas rregullores xheste te tilla nuk tolerohen nga Disiplina. Tirana ne ndeshjet e rradhes duhet te bej edhe pa te.